



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN241220200002

Tiranë, më: 25.02.2021

**Komisioni 09**

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-sëdhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri:

**VENDOSI :**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Ent Publik:** BASHKIA KOLONJE

**Nr. NIPT-i:** K48220001G

**Adresa e selisë:** Rr. “Rilindja”, Nr. banimit: 1, Kt: 1, K. postal: 1001, Erseke, Kolonje, Korçë

**Personi përgjegjës:** Erion Isai

Përtëzhvilluarprojektin: “**Studim Projektim Rruga Korce-Ersek Loti 2**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” indryshuar, Shtojca I, 7. ç) Ndërtimi I një rruge të re me katër ose me shumë kors, ose rregullimi dhe / ose zgjerimi I një rruge ekzistuese, që ka dy apo me pak kors, në mënyrë që të bëhet me katër ose me shumë kors, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe / ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose me shumë në gjatësi të vazhdueshme.

**Vendndodhja:** Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë

**Gjatësia totale e rrugës:** 17 km

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen ngazhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

- Në mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura
- Në rëndësinë publike të projektit

**2. Mendimi i institucioneve të konsultuara:**

*Drejtoritë teknike të Ministrisë shprehin mendimin si më poshtë:* Sugjerojmë që subjekti të përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës konkretisht Ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;

Ligjit nr. 81 Datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”; Ligjit nr.10 006, Datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar.

- Rekomandojmë të kryhen punime cilësore dhe rezistente ndaj dukurive ekstreme të motit, infrastrukturë e cila do të përshtatet ndryshimeve klimatike. Të jetë një ndërtim miqësor me mjedisin, strukturë e padëmshme për peisazhin e natyrës.

- Ndërtimi eko-miqësor do të uli ndikimin negativ në mjedisin tonë dhe burimet tona natyrore. Kjo përfshin transportimin e materialeve nga një distancë e largët, gjë që ka një ndikim negativ në energjinë e kërkuar për t'i transportuar ato. Sugjerojmë mbjelljen e pemëve përgjatë rrugës.

- Përsa i përket mbetjeve të gjeneruara gjatë ndërtimit të veprimtarisë rekomandojmë të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar

2. Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”

3. Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;

4. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”;

5. Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme.

6. Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar;

7.Mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;

- Duke patur parasysh se ndikimi në ajër i ndotjes akustike për këtë lloj aktiviteti do të jetë i përkohshëm, sugjerojmë të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave.

-E metimet në ajër do të vijnë si rezultat i përhapjes së pluhurave të materialeve të ndërtimit, materialit të gërmuar të sipërfaqes së tokës, si dhe nga djegia e lëndës djegëse së automjeteve.

Në këtë këndvështrim, gjatë fazës së zbatimit të projektit sugjerojmë:

Zbatimin me rigorozitet nga ana e zbatuesit të projektit, të planit të masave të propozuar në këtë raport, për uljen e emetimeve të mundshme në ajër, duke marrë në konsideratë;

i. Kontrollin e kushteve teknike në mënyrë periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve të gaztë, të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.

ii. Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse.

iii. Monitorimin e cilësisë së ajrit gjatë fazës së punimeve, matjen e pluhurave dhe lëndës së ngurtë pezull.

iv. Zbatimin e lagies gjatë gërmimeve, me qëllim reduktimin e shkarkimeve në ajër të treguesve NO<sub>x</sub>, PM<sub>10</sub>, SO<sub>x</sub>, CO<sub>2</sub>, VOC, etj.

v. Spërkatjen e rregullt me ujë të rrugës për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij gjatë transportit të materialeve të ndërtimit.

vi. Vendosija e sinjalistikës për punimet në zonën e projektit. Marrja e masave për menaxhimin dhe shmangien e trafikut, që do të krijohet për shkak të makinerive dhe automjeteve transportuese, menaxhimin në kohë të tij.

vii. Gjatë transportit, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.

viii. Kufizimin e shpejtësisë së automjeteve të punës.

ix. Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve mundësisht brenda zonës së punimeve.

x. Parandalimin e aksidenteve që shkaktojnë ndotje të ajrit ose mjedisit. Kur në mënyrë aksidentale ndodh derdhja e karburantit apo vajit, materiali i derdhur të mblidhet, të pastrohet vendi përkatës, dhe materialet e grumbullura të depozitohen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurtë.

xi. Punonjësit të përdorin dhe mbajnë rregullisht maskat kundër pluhurit.

xii. Parandalimin e aksidenteve që shkaktojnë ndotje të ajrit ose mjedisit. Kur në mënyrë aksidentale ndodh derdhja e karburantit apo vajit, materiali i derdhur të mblidhet, të pastrohet vendi përkatës dhe materialet e grumbullura të depozitohen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurtë.

xiii. Punonjësit të përdorin dhe mbajnë rregullisht maskat kundër pluhurit.

xiv. Në rast se për qëllime të këtij aktiviteti, synohet të përdoren bojra dhe kimikate, ato duhet të ruhen, menaxhohen dhe përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e kimikateve. Në cdo, rast, subjekti dhe punëtorët duhet të disponojnë informacionin e plotë dhe të updetuar mbi të dhënat e sigurisë nga kimikatet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zvogëluar ndikimin e tyre në shëndet dhe mjedis;

Shoqëria investitore, të zbatojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM-së.

Pas përfundimit të zbatimit të projektit, sugjerojmë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të mjedisit të ndikuar nga zhvillimi i këtij projekti.

Të krijohen sipërfaqe të gjelbërta dhe të garantohet mirëmbajtja e tyre.

Lidhur me kuadrin ligjor, për fushën e cilësisë së ajrit, sugjerojmë përditësimin e Ligjit Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, dhe Ligjit 10266/2010, me **Ligjin aktual në fuqi Ligjin nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”** marrja në konsideratë dhe respektimin e legjislacionit në fuqi që rregullon edhe Komponimet Organike të avullueshme (VOC);

të merret në konsideratë edhe Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe aktet nenligjore të dala në zbatim të tij.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:* Sipas raportit teknik, planimetrisë së përgjithshme dhe gjurmës së rrugës së projektit “Korçë – Ersekë Loti 2” rezulton se 600 metra linear e këtij segmenti rrugor, shtrihet brenda sipërfaqes së monumentit natyror (MN) “Dritaret e

Mbulesës Tektonike, Qinam - Vodice”, shpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumenteve të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura.

Sipas ligjit nr. 81/2017, neni 17, pika 2 citon; në një “Monument natyror zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument.

**Meqenëse ky investim po kryhet për përmirësimin e trasesë së rrugës ekzistues dhe është me rëndësi publike, ndaj zhvilluesit të projektit kërkohet të rishikohet gjurma e projekti për gjatësinë 600 metra me qëllim që të mos prekë monumentin natyror.**

*Agjencia Rajonale e Mjedisit: Shprehet parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit.*

- **Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**
- *Konsultimi me publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës sëshfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

- 3.1** Ky vendim është i vlefshëm, nëse ndërtimi i objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 3.3** Bazuar në mendimin e AKZM, ky projekt në asnjë mënyrë nuk duhet të cënojë zonën e mbrojtur monumentit natyror (MN) “Dritaret e Mbulesës Tektonike, Qinam - Vodice”, shpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumenteve të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura.
- 3.4** Sipas ligjit nr. 81/2017, neni 17, pika 2, në një “Monument natyror zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”. Të zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv, ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument.
- 3.5** **Bazuar në mendimin e AKZM-së subjekti të rishikojë gjurmën e projektit për gjatësinë 600 metra me qëllim që të mos prekë monumentin natyror.**
- 3.6** Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë për menaxhimin e mbetjeve inerte si dhe ujërave të ndotura sipërfaqësor duke mos i hedhur ato në lumë.
- 3.7** Të kryhen punimeve në gjurmët e projektit të propozuar.
- 3.8** Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 3.9** Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);

- 3.10** Për asnjë arsye mos të ketë prerje pemësh në zonën ku do të zhvillohet projekti.
- 3.11** Të mbillen pemë në ambientet e projektit të propozuar.
- 3.12** AKM sugjeron mbellje të bimëve autoktone në zonë.
- 3.13** Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi I banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët.
- 3.14** Të bëhet rrethimi I zones ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
- 3.15** Gjatë fazes së rikonstruksionit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, Brenda standarteve të OBSH-së;
- 3.16** Subjekti të kujdeset përmenaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke I transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për rmenaxhimin e mbetjeve inerte"
- 3.17** Për asnjë arsye mos të ketë hedhje të mbetjeve inerte pranë burimeve ujore.
- 3.18** Vendosja e ndriçimit gjatë rrugës të bëhet në bashkëpunim me organet kompetente të energjisë elektrike.
- 3.19** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negative në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.20** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.21** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.22** Në raste aksidentesh ose defektesh që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e populates që preket nga kyaksident.
- 3.23** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithëpunëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.24** Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 3.25** Në rast se gjatë fazes së ndërtimit, aktiviteti prek në zona të rëndësisë së veçantë, subjekti duhet të zbatojë kërkesat sipas Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" si dhe të vërë në dijeni, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si, autoritetin përkatës i cili ka për qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, si dhe menaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura dhe rrjetet e tjera natyrore si Natura2000, sipas planeve të menaxhimit të hartuara.

### **3.26 Monitorimi dhe Raportimi**

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria", zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

#### **- Zhurma dhe Vibracionet**

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara" dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.

- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	27.08.2021	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	27.08.2021	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	27.08.2021	Çdo 6 muaj

**- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	27.08.2021	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> 40 µg/m <sup>3</sup>	27.08.2021	Çdo 6 muaj

**- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

**Ngarkohet për zbatimin e detyrimeve të raportimit Shoqëria Ndërtuese që do të kryejë punimet për zhvillimin e projektit të cituar në këtë Vendim VNM.**

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**

*Konceptoi:*

*Miratoi:*

## Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit

